

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8007
E premte, 7 mars 2025
Çmimi 0.50 €

E tërë kjo hajni
dhe rrugaçëri për
një mandat

FAQE 5

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



NUK DO TË JETË I LEHTË FORMIMI I QEVERISË SË RE

FAQE 4-5



Lëvizja Vetëvendosja, e drejtuar nga Albin Kurti, doli partia e parë në zgjedhjet e 9 shkurtit, por nuk do të mund ta formojë e vetme qeverinë dhe i duhet të bëjë koalicione. Ehat Miftaraj, analist

politik, ka theksuar se skenari i parë është një koalicion në mes të LV-së, partive të komunitetit joshumicë (përjashtoj Listën Serbe) dhe një partie politike shqiptare. "Që ky skenar të

realizohet në praktikë, duhet qasje afruese nga LV-ja dhe një gjuhë të moderuar për të lënë hapësirë për bashkëpunim, e cila nuk ka ndodhur deri më tani", ka thënë Miftaraj

**LIDERËT SHTETËRORË
BËJNË HOMAZHE
NË PREKAZ: KULLAT
E JASHARËVE
U SHNDËRRUAN
NË SIMBOL TË NJË
KALAJE TË LIRISË**

F.7



**PËRFUNDON PROCESI I
NUMËRIMIT TË VOTAVE TË
ZGJEDHJEVE TË 9 SHKURTIT**

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE



**MACRONI SUGJERON ZGJERIMIN
E OMBRELLËS BËRTHAMORE TË
FRANCËS NË VENDET ALEATE
PËR SHKAK TË AGRESIONIT RUS**

F.2

**DEPARTAMENTI AMERIKAN I
MBROJTJES: NUK KA NDRYSHIME
TË PLANIFIKUARA PËR TRUPAT
NË KOSOVË**

F.4-5

**QEVERIA SHQIPTARE MIRATON
MBYLLJEN E TIKTOK-ut**

F.7

EKONOMI



**DHOMA E TREGTISË DHE
INDUSTRIË, E SHQETËSUAR ME
KAMATAT E LARTA TË KREDIVE
NGA BANKAT KOMERCIALE**

F.8

**UJI I KOSOVËS NË MAQEDONINË
E VERIUT PËRPLAS QËNDRIMET
E AUTORITETEVE PËR CILËSINË**

F.8

SPORT



DY DERBI NË SUPERLIGË

F.6

Macroni sugjeron zgjerimin e ombrellës bërthamore të Francës në vendet aleate për shkak të agresionit rus

PARIS, 6 MARS - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka thënë të mërkurën se do të ishte “çmenduri” të shpërfillë kërcënimin që tani përbën Rusia për Evropën dhe theksoi se është i hapur për bisedime për shtrirjen e ombrellës bërthamore të Francës në vendet aleate të Parisit në kontinent. Ai i bëri këto komente në prag të një takimi emergjent të liderëve të Bashkimit Evropian, që pritet të mbahet sot në Bruksel, për të diskutuar për rritjen e buxhetit ushtarak, që është kërkesë e rëndësishme e administratës amerikane për shkak të shqetësimeve në lidhje me përkushtimin e Uashingtonit ndaj NATO-s dhe çështjeve të sigurisë evropiane. Macroni tha në një fjalim televiziv se “ombrella jonë bërthamore na mbron neve: është e plotë, sovrane dhe plotësisht franceze”. “Megjithatë, duke iu përgjigjur thirrjes historike të kancelarit të ardhshëm gjerman [Friedrich Merz], kam vendosur ta hap debatin strategjik për mbrojtjen e aleatëve tanë në kontinentin evropian përmes ombrellës sonë [bërthamore]”, shtoi ai. Macroni tha se Franca do të duhet të shpenzojë më shumë për mbrojtjen dhe u zotua se Parisi do të vazhdojë ta mbështesë Kievin në luftën e tij



kundër pushtimit nga Rusia, që ka hyrë në vitin e katërt. “Rusia është bërë kërcënim për Francën dhe Evropën”, tha Macroni, duke shtuar se të shikosh dhe të mos bësh asgjë do të ishte marrëzi. Ai tha se shpreson se Shtetet e Bashkuara “do të mbeten përkrah nesh”, por shtoi se Evropa duhet të jetë e përgatitur për të kundërtën. “E ardhmja e Evropës nuk ka pse të vendoset në Uashington apo Moskë”, tha Macroni. “Pafajësia e 30 viteve të fundit... ka marrë fund”. “Kush mund të besojë se

Rusia e sotme do të ndalet në Ukrainë? Rusia është bërë kërcënim për Francën dhe Evropën dhe do të mbetet e tillë për vitet në vijim”, shtoi ai, duke shtuar se përtej Ukrainës, kërcënimin rus është i pranishëm dhe ndikon në vendet e Evropës. “Na prek edhe neve”, nënvizoi Macron. Të gjitha kombet kërkojnë t'i mbajnë të fshehta hollësitë e arsenalit të tyre bërthamor, dhe Macronu nuk foli në veçanti për hollësitë kur sugjeroi zgjerimin e ombrellës bërthamore të Francës.

Ombrella bërthamore e Francës u zhvillua nga presidenti i atëhershëm, Charles de Gaulle, në fillim të viteve '60, i krijuar për të qenë plotësisht i pavarur nga Shtetet e Bashkuara, të cilat në atë kohë ishin në garë për armë bërthamore me Bashkimin Sovjetik. Qëndrimet e Macronit janë shprehur nga lideri i partisë së ekstremit të djathtë në Francë, i cili tha se “mbrojtja e interesave franceze nuk ndalet në kufijtë [francezë]”. Sipas Federatës së Shkencëtarëve Amerikanë,

Shtetet e Bashkuara (5 044 koka bërthamore) dhe Rusia (5 580) zotërojnë rreth 88 për qind të inventarit të përgjithshëm të armëve bërthamore në botë. Franca ka rreth 290 koka bërthamore dhe Britania rreth 225, sipas faqes së internetit të federatës. Kina ka rreth 500. Macroni, i cili ka kërkuar prej kohësh të luajë rol aktiv diplomatik që nga pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia, tha se po planifikon një takim me aleatët evropianë javën e ardhshme për të diskutuar mundësinë e dërgimit të forcave paqeruajtëse në Ukrainë në rast të një marrëveshjeje për armëpushim ose një akordi afatgjatë. “Për të siguruar që Ukraina të mos pushtohet nga Rusia përsëri pas një marrëveshjeje paqeje, ne duhet të përgatitemi për këtë”, tha Macroni, duke theksuar se: “Javën e ardhshme do të mblidhen në Paris shefat e shtabit të ushtrive të shteteve që dëshirojnë t'i kryejnë përgjegjësitë e tyre në këtë drejtim. Ukraina ka të drejtë për paqe dhe siguri, dhe kjo është në interesin tonë, është në interes të sigurisë së kontinentit evropian. Në këtë kuadër, ne po punojmë së bashku me miqtë tanë në Britaninë e Madhe, Gjermani dhe disa shtete të tjera evropiane”, përfundoi ai.

Gjykata Supreme urdhëron Trumpin ta zhbllokojë ndihmën ndërkombëtare

WASHINGTON, 6 MARS - Gjykata Supreme amerikane më 5 mars rivendosi urdhrin që administrata e presidentit amerikan Donald Trump ta zhbllokojë ndihmën ndërkombëtare të ngrirë, por nuk është e qartë se sa shpejt mund të zhbllokohen këto fonde. Në një votim me rezultat 5 me 4, Gjykata Supreme refuzoi apelin urgjent nga administrata amerikane, ndërkohë që i kërkoi gjykatësit të Gjykatës të shkallës së parë, Amir Ali, që ta sqarojë urdhrin e tij të mëparshëm që kërkon zhbllokimin e shpejtë të gati dy miliardë dollarëve ndihmë për punën që veçse është kryer. Pavarësisht se ky vendim mund të konsiderohet humbje, në terma afatshkurtër, për administratën e Trumpit, grupet jofitimprurëse dhe bizneset që kanë paditur janë ende duke pritur paratë që thonë se ju takojnë. Një nga organizatat javën e kaluar u detyrua të pushonte nga puna 110 punonjës si pasojë e mungesës së fondeve, u tha në dokumentet e gjykatës. Gjykatësi Samuel Alito ishte në mesin e katër gjykatësve që kundërshtuan vendimin, duke thënë se Ali nuk ka autoritetin t'i urdhërojë pagesat.

Alito shkroi se ishte i habitur që Gjykata po “imponon një dënim prej 2 miliardë dollarësh mbi taksapaguesit amerikanë”. Vendimi i Supremes lë në fuqi urdhrin për ndalimin e përkohshëm të lëshuar nga gjykatësi Ali, i cili kishte pezulluar ngrirjen e shpenzimeve. Ali do të mbajë një seancë dëgjimore për të shqyrtuar një pezullim më afatgjatë.

Shumica e gjykatësve në vendim thanë se administrata nuk kishte sfiduar urdhrin fillestar të gjykatësit Ali, por vetëm afatin, i cili ka skaduar javën e kaluar. Gjykata Supreme i tha gjykatësit Ali që të “sqarojë çfarë obligimesh duhet të përmbushë qeveria për të siguruar që t'i përmbahet urdhrit për ndalim të përkohshëm”. Kryegjykatësi John Roberts dhe gjykatësja Amy Coney Barrett, që të dy konservatorë, iu bashkuan tre gjykatësve të tjerë liberalë për ta krijuar shumicën për këtë vendim. Administrata Trump ka argumentuar se situata ka ndryshuar pasi ka ndryshuar bllokimin e përgjithshëm të



shpenzimeve me vlerësimet individuale që çuan në anulimin e 5 800 kontratave të Agjencisë amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe 4 100 grante të tjera të Departamentit të Shtetit, vlera e të cilave në total arrin gati në 60 miliardë dollarë. Qeveria federale ka ngrirë ndihmën ndërkombëtare pas një urdhri ekzekutiv të nënshkruar nga Trumpi që shënjestroi

programet që ai i cilësoi si të padobishme dhe që nuk përputheshin me objektivat e politikës së tij të jashtme. Në padinë që pasoi u pretendua se ky pezullim u bë në kundërshtim me ligjin federal dhe me të u tha se është ndërprerë financimi edhe për programet më urgjente jashtë ShBA-së që shpëtojnë jetë. Gjykatësi Ali urdhëroi rinisjen e përkohshme të financimit duke

nisur më 13 shkurt, por dy javë më vonë ai gjeti se qeveria nuk po tregonte sinjale se do ta respektonte këtë masë dhe vendosi një afat tjetër për kryerjen e pagesave për punën që veçse ka përfunduar. Administrata e apeloj këtë vendim, duke e quajtur urdhrin “të gabuar” dhe e kundërshtoi afatin e caktuar për zhbllokimin e fondeve.

NUK DO TË JETË I LEHTË FORMIMI I QEVERISË SË RE

Lëvizja Vetëvendosja, e drejtuar nga Albin Kurtit, doli partia e parë në zgjedhjet e 9 shkurtit, por nuk do të mund ta formojë e vetme qeverinë dhe i duhet të bëjë koalicion. Ehat Miftaraj, analist politik, ka theksuar se skenari i parë është një koalicion në mes të LV-së, partive të komunitetit joshumicë (përjashtoj Listën Serbe) dhe një partie politike shqiptare. “Që ky skenar të realizohet në praktikë, duhet qasje afruese nga LV-ja dhe një gjuhë të moderuar për të lënë hapësirë për bashkëpunim, e cila nuk ka ndodhur deri më tani”, ka thënë Miftaraj

PRISHTINË, 6 MARS - Lëvizja Vetëvendosja e Albin Kurtit doli partia e parë në zgjedhjet e 9 shkurtit, por nuk do të mund ta formojë e vetme qeverinë dhe i duhet të bëjë koalicion. Të mërkurën mori fund i gjithë procesi i numërimit të votave për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë. Lëvizja Vetëvendosja e kryeministrit Albin Kurti renditet partia e parë me 42.28 % të votave, duke siguruar 48 mandate. E dyta renditet Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me 20.96 %, duke siguruar 24 mandate. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) fitoi 18.43 % dhe siguroi 20 mandate, ndërsa Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma fituan vetëm 7.08 %, duke siguruar 8 mandate. 20 ulëse në Kuvendin e Kosovës janë të rezervuara për pakicat, 10 nga to për serbët e Kosovës. “KQZ-ja është e obliguar që të presë të paktën 48 orë para se t’i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës. Ky nen parasheh mundësinë që në PZAP, në një afat brenda 48 orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, të paraqiten ankesat për administrimin e numërimit që është zhvilluar në Qendrën e

Numërimit dhe Rezultateve”, tha zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi. Por si e shohin situatën aktuale analistët politikë, ku Vetëvendosja e Kurtit nuk e mori shumicën absolute për ta formuar e vetme qeverinë? Sipas tyre, rezultati i komplikon gjërat dhe, realisht, të dyja palët mund ta formojnë qeverinë me koalicion: edhe Vetëvendosja, por edhe të gjitha partitë opozitare së bashku.

Cilët janë skenarët e mundshëm?

Ehat Miftaraj, analist politik, i tha DW-së se “edhe përkundër faktit që LV-ja nuk ka marrë votat e mjaftueshme për ta formuar qeverinë, duke marrë për bazë specifikat që ka sistemi kushtetues në Kosovë, mbesin disa skenarë, që ndikohen si nga faktorë të brendshëm ashtu edhe nga ata të jashtëm”. “Skenari i parë është një koalicion mes LV-së, partive të komunitetit joshumicë (përjashtoj Listën Serbe) dhe një partie politike shqiptare. Që ky skenar të realizohet në praktikë, do të kërkonte qasje afruese nga LV-ja dhe një gjuhë të moderuar



për të lënë hapësirë për bashkëpunim, e cila nuk ka ndodhur deri më tani. Përkundrazi, lideri i LV-së i quajti liderët opozitarë me gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë ofenduese si ‘hajvanë’, që në gjuhën shqipe është sinonim i fjalës ‘kafshë’. Në këtë drejtim është krijuar përshtypja se LV-ja, të paktën në publik me veprimet e saj, po abstenson nga e drejta për ta formuar qeverinë e ardhshme, duke krijuar atmosferë dhe klimë përçarëse e polarizuese kundër të gjithëve”, thotë Miftaraj.

Por nga analistët shihen edhe skenarë të tjerë të mundshëm si, për shembull, formimi i qeverisë së pakicës nga ana e partive politike opozitare, së paku me komunitetet joshumicë. Analisti Miftaraj e

parashikon si të mundshëm këtë skenar, nëse ka vullnet politik mes tri partive politike opozitare. “Me kushtin që ta gjejnë gjuhën e përbashkët dhe së paku dy parti opozitare të pajtohen që pozita e kryeministrit t’i takojë njëres prej tyre, ta harmonizojnë programin qeveritar dhe të pajtohen për qëndrimet lidhur me dialogun Kosovë - Serbi dhe çështje të tjera me rëndësi, si raportet me BE-në, masat ndëshkuese etj”.

BE-ja pret formimin e qeverisë së re në Kosovë

Zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë u mbajtën pa incidente. Pas një bojkoti disavjeçar, në zgjedhje mori

pjesë edhe Lista Srpska, partia më e madhe e serbëve të Kosovës.

Në deklaratën e përbashkët të drejtueses së diplomacisë evropiane, Kaja Kallas, dhe komisionares për Zgjerimin, Marta Kos, thuhet se BE-ja pret që në Kosovë të formohen Kuvendi dhe qeveria e re. “Bashkimi Evropian pret që Kuvendi dhe qeveria e re të formohen në përputhje me vullnetin e popullit dhe se do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në rrugën e saj për ta arritur integrimin evropian, përfshirë zbatimin e angazhimeve të saj, sidomos në lidhje me marrëdhëniet me Serbinë dhe forcimin e sundimit të ligjit”.

Në deklaratën e BE-së u bëhet thirrje autoriteteve në Kosovë që të angazhohen për bashkëpunim rajonal të përgjegjshëm dhe t’i shtojnë përpjekjet për ta forcuar sundimin e ligjit dhe administratën publike, si dhe për ta mbrojtur lirinë e shprehjes. “Progresi në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë është mënyra e vetme që Kosova të arrijë në rrugën evropiane”, theksohet në deklaratë.

Në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit garuan 28 subjekte politike dhe një kandidat i pavarur. Katër kandidatë nga katër partitë më të mëdha garuan për postin e kryeministrit. Të drejtë vote kishin rreth dy milionë qytetarë, ndërsa votuan vetëm rreth 800 mijë që, shndërruar në përqindje, pak mbi 40 %. Kuvendi i Kosovës i ka 120 ulëse dhe, në bazë të rezultatit, Lëvizja Vetëvendosja, që doli partia e parë, nuk do të mund ta formojë e vetme qeverinë. Asaj i duhet koalicion me ndonjërin nga partitë e tjera.

PËRFUNDON PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZGJEDHJEVE TË 9 SHKURTIT

PRISHTINË, 6 MARS - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës (KQZ) e ka përfunduar procesin e numërimit të votave rreth një muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare në vend më 9 shkurt.

Votat me kusht dhe votat e personave me nevoja të veçanta ishin të fundit që u numëruan në Qendrën e Numërimit të Rezultateve. KQZ pritet t’i shpallë rezultatet përfundimtare për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dy ditë pas përfundimit të numërimit të të gjitha votave. Zëdhënësi i KQZ-së, Vlamir Elezi, tha për gazetarë se partitë apo kandidatët për deputetë kanë 48 orë kohë për të bërë ankesa në

Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) në lidhje me ndonjë shkelje të supozuar gjatë numërimit që është zhvilluar në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve.

Sipas të dhënave të KQZ-së, partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, i ka fituar edhe votat me kusht dhe ato të personave me nevoja të veçanta. Ajo i ka fituar 5 214 vota me kusht, apo 44.25 për qind, si dhe 824 apo 31.88 për qind e votave të personave me nevoja të veçanta. Partia Demokratike e Kosovës i fitoi 20.17 për qind, apo 2 377 vota me kusht dhe 621 apo 24.02 për qind të votave të personave me nevoja të veçanta. Lidhja Demokratike e Kosovës i mori 13.64 për qind, apo 1 607 vota me kusht, dhe 19.54 për qind apo 505 vota të personave



me aftësi të kufizuara. Lista Serbe arriti t’i fitojë 6.33 për qind, apo 746 vota me kusht, dhe 7.85 për qind apo 203 vota të personave me nevoja të veçanta. Ndërsa koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-Nisma i mori 5.63 për qind, apo 4663 vota

me kusht dhe 8.86 për qind, apo 229 vota të personave me nevoja të veçanta. Sipas rezultateve përfundimtare, që përfshijnë edhe votat në vendvotimet në Kosovë, ato në përfaqësitë diplomatike dhe me postë, asnjëra parti nuk ka

siguruar numër të mjaftueshëm për të qeverisur e vetme. Për ta pasur shumicën, nevojiten së paku 61 deputetë në Kuvendin me 120 ulëse të Kosovës. Si partia e parë, Vetëvendosja i ka fituar 396 022 vota, apo 42.27 për qind, duke i siguruar 48 ulëse, PDK-ja 24, LDK-ja 20 dhe AAK-Nisma 8 ulëse. Udhëheqësi i saj, kryeministri Albin Kurti, është zotuar se do ta formojë qeverinë në mënyrë të pavarur. Partitë aktualisht në opozitë, përveç Nismës, e kanë përjashtuar mundësinë e koalicionit me të. KQZ-ja pritet ta bëjë certifikimin e rezultateve në mes të këtij muaji. Analistët thonë se ka disa opsione të mundshme për formimin e qeverisë së re.



DEPARTAMENTI AMERIKAN I MBROJTJES: NUK KA NDRYSHIME TË PLANIFIKUARA PËR TRUPAT NË KOSOVË

Prishtinë, 6 mars - Për më shumë se 25 vjet misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, ofron siguri. Por në kohën kur zyrtarët amerikanë sinjalizojnë zvogëlimin e mundshëm të pranisë së tyre ushtarake në Evropë, lindin edhe pyetjet: a do të mbeteshin ushtarët amerikanë në KFOR, apo do të kërkonte administrata Trump favore në këmbim të tyre? Nga Departamenti amerikan i Mbrojtjes thonë për Radion Evropa e Lirë se tash për tash nuk ka ndonjë ndryshim sa i përket pozicionimit të forcave të tyre. Por, me tensionet e vazhdueshme në Ballkan dhe me ndryshimin e prioriteteve globale, Kosova duhet të përgatitet për çdo skenar, thonë ish-zyrtarë të NATO-s. “Secili ushtar i KFOR-it e kupton plotësisht dhe qartë detyrën e tij për t’i mbrojtur të gjithë qytetarët e Kosovës”, deklaroi më 25 qershor të 1999-s komandanti i atëhershëm i misionit paqeruajtës të NATO-s, Mike Jackson. Kjo forcë nisi të dislokohej në Kosovë atë muaj, menjëherë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, e cila detyroi tërheqjen e plotë të ushtrisë dhe policisë serbe nga Kosova. Fillimisht përbëhej nga rreth 50

000 trupa, për të arritur me kalimin e viteve në rreth 4 600. Më shumë se 25 vjet më vonë misioni i saj mbetet i njëjtë: “ruajtja e një mjedisi të sigurt për të gjithë”, por e ardhmja e forcës disi e diskutueshme. Një zyrtar nga Departamenti amerikan i Mbrojtjes konfirmon për Radion Evropa e Lirë se “tash për tash nuk ka asnjë ndryshim në pozicionimin e forcave për të njoftuar”. Por, ish-zyrtari i lartë i NATO-s, Jamie Shea, thotë se presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, “është transaksional” dhe se mund të kërkojë nga Kosova favore në këmbim të mbajtjes së trupave. “Ndaj, jini të përgatitur”, thotë Shea për Radion Evropa e Lirë. Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, vlerëson se vendi, aktualisht, nuk është në gjendje të vetëmbrohet.

Si lindën pikëpyetjet për trupat amerikane në Evropë?

Ishte fillimisht sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, i cili porositi Evropën

se duhet të përgatitet për një rishikim dhe reduktim eventual të pranisë ushtarake amerikane. Gjatë një vizite në Varshavë, muajin e kaluar, Hegseth tha se e ardhmja e saj do të varet nga kërcënimet globale dhe prioritetet strategjike amerikane. “Kjo është arsyeja përse mesazhi ynë është kaq i ashpër për aleatët tanë evropianë. Tani është koha për të investuar, sepse nuk mund të supozoni se prania e Amerikës do të zgjasë përgjithmonë”, tha ai më 14 shkurt. Sipas një dokumenti që siguroi gazeta amerikane “The Washington Post”, Hegseth urdhëroi, gjithashtu, udhëheqësit e Pentagonit dhe të ushtrisë amerikane që të bëjnë plane për shkurtimin e buxhetit të mbrojtjes për 8 për qind, në secilin prej pesë vjetëve të ardhshëm. Këtij debati, një element tjetër ia shtoi edhe zëvendës-presidenti amerikan, JD Vance. Ai i kritikoi udhëheqësit evropianë për refuzimin e së djathtës ekstreme, ndërsa të ardhmen e trupave amerikane në Evropë e lidhi me

politikëbërjen në kontinent. Duke folur në Konferencën e Veprimet Politik Konservator më 20 shkurt, Vance tha se amerikanët nuk do të mbështesin mbajtjen e trupave në Gjermani, nëse njerëzit atje mund të burgosen për postime fyese në mediat sociale. “E gjithë mbrojtja e Gjermanisë subvencionohet nga taksapaguesit amerikanë”, tha ai. Situata shkaktoi jo pak ankth në mesin e aleatëve këndej Atlantikut. Njeriu që pritet të bëhet kancelar i Gjermanisë, Friedrich Merz, tha se synim i tij do të jetë arritja e pavarësisë nga ShBA-ja në aspektin e sigurisë. “Për mua, prioritet absolut do të jetë forcimi i Evropës sa më shpejt që të jetë e mundur”, tha ai. Trump, edhe gjatë mandatit të parë si president, u ka kërkuar vazhdimisht aleatëve evropianë që t’i rrisin ndjeshëm kontributet e tyre financiare në mbrojtje. I pyetur gjatë një konference me gazetarë, më 18 shkurt, se a do të ishte i gatshëm të konsideronte tërheqjen e të gjitha trupave

amerikane nga Evropa, në kuadër të një marrëveshjeje me presidentin rus, Vladimir Putin, për paqe në Ukrainë, Trump tha: “Askush nuk më ka kërkuar ta bëj këtë. Nuk mendoj se duhet ta bëjmë. Nuk do të doja ta bëja”.

Prania e trupave amerikane në Evropë

Shtetet e Bashkuara kanë disa baza operative dhe ushtarake në Evropë. Numri më i madh i ushtarëve amerikanë - mbi 35 000 - është i dislokuar në Gjermani. Ky vend, njëherësh, ka edhe bazën më të madhe ajrore amerikane - Ramstein - ku janë të vendosur mbi 16 000 ushtarakë, civilë e kontraktorë. Përveç përforcimit të përkohshëm në fillim të luftës së Rusisë në Ukrainë, prania ushtarake amerikane në Evropë ka shkuar duke u zvogëluar që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë. Sipas Komandës Evropiane të ShBA-së, numri i përgjithshëm i forcave amerikane në Evropë është luhatur mes 75 000 dhe

105 000 që nga viti 2022. Prej tyre, aktualisht, rreth 63 000 forca janë të dislokuara në mënyrë të përhershme, ndërsa të tjerat janë me rotacion. Në Kosovë, Shtetet e Bashkuara kanë rreth 600 ushtarë në kuadër të misionit KFOR, në krahasin me mbi 5.000 sa kishin në '99-tën. Nga ai vit kanë edhe kampin Bondsteel, i cili gjendet pranë Ferizajt, në juglindje të Kosovës, dhe shërben si baza më e madhe ushtarake e ShBA-së në Ballkan.

Çfarë thotë NATO-ja?

Radio Evropa e Lirë pyeti NATO-n se a ka ndonjë plan për të siguruar që prania e KFOR-it në Kosovë mbetet e pandryshuar, në vazhden e reduktimit të mundshëm të trupave amerikane në Evropë. Në përgjigjen që mori, mes tjerash, thuhet se “zyrtarët amerikanë e kanë bërë të qartë angazhimin e tyre ndaj Aleancës, përfshirë praninë e ShBA-së në Evropë”. Aty, po ashtu, thuhet se ShBA-ja i ka bërë të qarta pritjet e saj që aleatët e NATO-s të bëjnë më shumë, të investojnë më shumë dhe të prodhojnë më shumë, “në mbështetje të sigurisë sonë të përbashkët”. “NATO-ja vazhdimisht i përshtatet mjedisit që ndryshon... KFOR-i vazhdon të zbatojë mandatin e tij - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999 - për të kontribuar në një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë”, tha një zyrtar i NATO-s dhe shtoi se “ShBA-ja vazhdon të luajë një rol themelor” brenda misionit KFOR. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha në një takim me komandantin e KFOR-it, Enrico Barduani, më 4 mars, se Evropa po përballet me një situatë të ndërlikuar gjeopolitike dhe se “angazhimi i përbashkët me KFOR-in dhe NATO-n mbetet thelbësor”.

“Jini të përgatitur”

Shea, i cili ka shërbyer në role të ndryshme në NATO deri në tërheqjen e tij në vitin 2018, nuk pret ndryshime të menjëhershme në praninë e trupave amerikane në Evropë, e rrjedhimisht as në Kosovë, por thotë se situata mbetet e pasigurt dhe duhet vëzhguar me kujdes. Sipas tij, kontingjenti amerikan në Kosovë është i vogël dhe “nuk

është barrë e madhe financiare për ShBA-në, në krahasin me forcat amerikane në Gjermani apo Poloni”. Ai gjithashtu kujton se Trumpi në të kaluarën “është përpjekur ta luajë paqebërësin mes Beogradit dhe Prishtinës” dhe thotë se trupat amerikane në Kosovë “i japin ShBA-së një levë më të madhe në këtë rol”. “Por, Trump është transaksional dhe ai mund ta pyesë Kosovën se çfarë favoresh mund t'i ofrojë për t'i mbajtur trupat [amerikane] në Kosovë - sidomos në formë të marrëveshjeve biznesore dhe mundësive për investime. Ndaj, jini të përgatitur”, thotë Shea. Për më tepër, shton ai, zvogëlimi i buxhetit të Pentagonit do ta detyrojë me doemos ushtrinë amerikane të bëjë kursime dhe t'i rishpërndajë burimet e saj.

Pse është e rëndësishme prania e NATO-s në Kosovë?

Gati 26 vjet pas përfundimit të luftës dhe 17 vjet pas shpalljes së pavarësisë, Kosova nuk njihet nga Serbia dhe marrëdhëniet mes dy vendeve mbeten të tensionuara. Ndonëse janë në negociata për normalizimin e tyre qysh në vitin 2011, shteti fqinj vazhdon ta konsiderojë Kosovën si pjesë të veten. Pas një sulmi të armatosur në veri të vendit, më 2023, autoritetet kosovare e akuzuan atë për tentim aneksimi të kësaj zone të banuar me shumicë serbe. Serbia mohoi se kishte gisht në atë sulm, por grumbulloi për disa ditë trupa ushtarake në kufi me Kosovën. Forca e Sigurisë e Kosovës nuk jep informacione për kapacitetet e saj mbrojtëse, duke i konsideruar si të ndjeshme, por ish-komandanti i saj, Kadri Kastrati, vlerëson se vendi, aktualisht, nuk është në gjendje të vetëmbrohet. “Fatkeqësisht, jemi shumë larg, sepse nuk është investuar”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. “Jemi shumë larg edhe kapaciteteve njerëzore, edhe atyre infrastrukture, pajisjeve dhe armatimit”, shton ai. FSK-ja është në proces të shndërrimit në ushtri të rregullt dhe pritet t'i ketë mbi 7.500 pjesëtarë aktivë dhe rezervistë, nga rreth 2.500 sa ka aktualisht. Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, i ka thënë Radios Evropa e Lirë në fund të vitit të kaluar se Kosova, në katër vjet, ka shpenzuar mbi 269 milionë euro për blerje të

armatimit. Ajo që dihet është se vendi ka siguruar armë edhe nga dy fuqi të NATO-s: ShBA-ja dhe Turqia, dhe se synon të ndërtojë edhe fabrikën e tij për prodhimin e municioneve. Duke folur për rëndësinë e NATO-s në Kosovë, ish-ministri i Mbrojtjes, Agim Çeku, thotë se situata e sigurisë në vend nuk ka ndryshuar në mënyrë thelbësore që nga ndërhyrja e aleancës ushtarake në vitin 1999. “NATO-ja ka ardhur në Kosovë për shkak të qasjes agresive të Serbisë ndaj Kosovës dhe shqiptarëve. Fatkeqësisht, kjo qasje nuk ka ndryshuar ende. Serbia vazhdon ta trajtojë Kosovën si pjesë të saj dhe vazhdon të ushqejë ëndrra për kthimin e saj në Kosovë”, thotë Çeku për Radion Evropa e Lirë. Derisa të mos ketë marrëveshje për njohje reciproke mes Kosovës e Serbisë, ai thotë se misioni i NATO-s, KFOR, do të mbetet faktor kyç për sigurinë në vend. “Ai është garanci edhe për stabilitetin e gjithë Ballkanit Perëndimor”, thotë Çeku. Në frymë të ngjashme me Çekun shprehet edhe ish-ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë, Fatmir Mediu. “Ballkani ka një rëndësi të madhe strategjike për NATO-n, veçanërisht për shkak të daljes në Mesdhe dhe Adriatik. Por, për Kosovën, prania e NATO-s është edhe më e rëndësishme - për të garantuar stabilitetin e saj dhe për të parandaluar destabilizimin e situatës nga aktorë të tillë si Serbia, Rusia e Kina”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

A do të mund të mbijetonte KFOR-i pa ushtarë amerikanë?

Ish-zyrtari i NATO-s, Shea, thotë “po”. “KFOR-i ka qenë nën komandën italiane dhe turke dhe pjesa më e madhe e trupave janë evropiane”, thotë ai dhe shton se “evropianët menaxhojnë vetë me Bosnje e Hercegovinën që nga viti 2004”. Por, pavarësisht kësaj, Shea argumenton se mbajtja e trupave amerikane në Kosovë sa më gjatë që të jetë e mundur, është e dobishme, sepse, siç thotë, siguron vëmendjen e vazhdueshme të ShBA-së. “Çizmet e ShBA-së në terren e mbajnë Kosovën në ekranin e radarit në Shtëpinë e Bardhë dhe në Departamentin e Shtetit, si dhe ndihmojnë që ShBA-ja të mbetet e angazhuar në dialogun Kosovë-Serbi”, thotë Shea. Me rritjen e pasigurisë në rajon -

për shkak të gjykimit të udhëheqësit të Republikës Sërpska, Millorad Dodik, dhe protestave të vazhdueshme në Serbi - forcat amerikane shërbejnë si një faktor stabilizues, sipas tij.

Si mund të përgatitet Kosova për secilin skenar?

Mediu thotë se është koha që Kosova të rreshtohet sa më pranë NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara, “e jo të ndjekë politika të brendshme që sjellin përçarje”. “Vendi duhet të ketë një qasje proaktive për anëtarësim në NATO dhe t'i thellojë marrëdhëniet strategjike me ShBA-në”, thotë ai. Aktualisht deputet në Kuvendin e Shqipërisë, Mediu sugjeron edhe krijimin e një force të përbashkët ushtarake me vendet anëtare të NATO-s në Ballkanin Perëndimor - Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi - për të ndërtuar, siç thotë, një mekanizëm të fuqishëm mbrojtës. “Stabiliteti i Kosovës dhe i gjithë rajonit nuk mund të lihet në mëshirën e fatit”, thotë Mediu. Shea thekson gjithashtu rëndësinë e angazhimit të Kosovës me administratën e Trumpit në të gjitha nivelet, “për të siguruar se interesat e saj komunikohen drejt dhe befasishtë shmangen”. “Trump është i paparashikueshëm, kështu që, më së miri, përgatituni për të gjithë skenarët”, thotë Shea. Marrë parasysh stilin transaksional të diplomacisë së presidentit amerikan, Shea shton se Kosova duhet t'i identifikojë edhe fushat për negociata të mundshme me të. Interesat biznesore janë gjithmonë të larta, thotë ai, duke marrë si shembull edhe marrëveshjen e përfolur mes ShBA-së dhe Ukrainës për mineralet. Nevoja për këtë balancë delikate, që përcakton sigurinë e Kosovës, ishte evidente qysh në vitin 1999, kur gjenerali Jackson - tashmë i ndjerë - refuzoi urdhrin e komandantit të tij amerikan për të bllokuar forcat ruse kur hynë në Kosovë, pa marrëveshje me NATO-n. “Nuk do ta filloj Luftën e Tretë Botërore për ju”, u raportua t'i ketë thënë Jackson gjeneralit Wesley Clark në qershor të '99-s. Nëse Jackon e parandaloi atë mbi çerek shekulli më parë, përse siguria sot do t'i lihej rastësisë?!



Murati: Anomalia e votave me postë për LDK-në vërehet edhe me sy të lirë

PRISHTINË, 6 MARS - Ministri i Financave dhe kandidati për deputet, Hekuran Murati, ka reaguar në lidhje me procesin zgjedhor, sidomos për votat me postë për LDK-në. Ai ka thënë se anomalia e votave me postë për LDK-në vërehet edhe me sy të lirë. “Pa ndonjë analizë të thelluar mund të konstatohet se kemi të bëjmë me manipulim të votave me postë, në shkallë industriale madje. Këtë më së miri e shpërfaq krahasimi i votave me postë sivjet, me votat me postë nga zgjedhjet nacionale të vitit 2021. Përderisa LV qëndron pothuajse pandryshuar, kurse PDK e AAK kanë një rritje prej 32%-48%, tek LDK rritja është abnormale me mbi 367%. Nëse do të supozonim trend të njëjtë të rritjes edhe tek LDK-ja sikurse tek partitë tjera, atëherë i bie se keqpërdorimi sillet tek 13-14 mijë vota. Pra nuk është ndonjë gjë që mund të tejkalohet në heshtje”, ka shkruar Murati në “Facebook”. Ai ka thënë se diçka e ngjashme, por në shkallë më të vogël, ishte tentuar në zgjedhjet e vitit 2021, pikërisht nga anëtarë të LDK-së, të cilët ishin zënë duke keqpërdorur identitetin e 72 qytetarëve që jetojnë në Austri. “Për këtë ka edhe të dënuar nga gjykata. Kjo do të duhej të ishte e mjaftueshme për të alarmuar prokurorinë të fillojë hetimin për të zbuluar skemën dhe identifikuar keqbërësit. Deri më tani nuk kemi parë ndonjë veprim. Kurse Lumir Abdixhiku në anën tjetër, më e pakta që mund të bëjë është që t'i bashkohet thirrjes për hetim dhe zbardhje të rastit”, ka shkruar Murati.

Bedri Hamza: Institucionet e reja duhet të krijohen pa vonesë

PRISHTINË, 6 MARS - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka thënë se procesi zgjedhor po shkon drejt fundit dhe në ditët e ardhshme presim të certifikohen edhe rezultatet zgjedhore. Ai deputetëve të zgjedhur të të gjitha subjekteve politike u ka dëshiruar suksese në punën e tyre. “Nga mandatet e

fituara buron edhe detyra e shenjtë për t'u shërbyer me ndershmëri dhe përgjegjësi atyre që besuan te secili i zgjedhur. Faleminderit mbi 196 mijë qytetarëve që besuan te Partia Demokratike e Kosovës! Faleminderit për mbështetjen që na e keni dhënë për ta bërë Kosovën më të mirë!”, ka shkruar

Hamza në “Facebook”. Ai ka thënë se institucionet e reja duhet të krijohen pa vonesa dhe, sipas tij, “është përgjegjësi e jona t'i respektojmë afatet ligjore dhe të jemi transparentë”. “Së bashku duhet t'i mbrojmë vlerat që na bashkojnë, interesin publik dhe vendin tonë!”, ka shkruar Hamza.



E TËRË KJO HAJNI DHE RRUGAÇËRI PËR NJË MANDAT



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Votat e Martinit dhe të Donikes: Përfaqësuesit e injorancës politike dhe mohuesit e UÇK-së, menjëherë kur kuptuan se me vota të rregullta dhe pa koalicion me hajvanët, nuk e bëjnë dot qeverinë, shpresat i varnin te votat e opozitës sidomos pasi u numëruan “votat e Martinit dhe të Donikës” e që dolën të jenë afërsisht 82 për qind. Martin GEN Berishaj, me emrin artistik, Martin Struja, i barte votat me vete dhe privatisht sikur të ishin eurot e GEN-it të Beogradit që i nxori në një bankë në Prishtinë, sikur të ishte në Bahçen e (Albin) Babës. Martin Struja ishte intervistuar në Prokurorinë Speciale të Kosovës, sigurisht jo për shkuarje në Haxh mirëpo duket se nuk ia lë as shenjë në të vogël të përgjegjësisë për kumarinë me Serbinë ndryshe nuk do të ngatërrohej me vota të diasporës. Është peng i paudhësive dhe të palarave të veta dhe për t'i shpëtuar lavatriçes së ligjit, ka hyrë në kanalizimin e Kurtit, për të shpëtuar prapanicën! Donika Shvarci, kryeinjorantja e diplomacisë dhe besnikja e Gjykatës Raciste Speciale, pasi i shndërroi ambasadat dhe konsullatat në qendra të prostituimit diplomatik, ua shtoi edhe një detyrë shtesë, trafikimin me votues dhe vota. Prandaj ishin 82 për qind. Për këtë arsye kori i injorantëve dhe antikombëtarëve deklaronte se votat me postë të diasporës do të jenë përcaktuese për formimin e qeverisë Kurthi 3. Kur nuk u doli si menduan, po e godasin LDK-në kinse për manipulim me vota me postë. Po të mos i fitonte LDK-ja 30 për qind të këtyre votave dhe po t'i fitonte 5 për qind, askush nga LDK-ja nuk do të akuzohej për manipulim. Po akuzohet djali i Salih Çekajt pse mori aq shumë

vota në diasporë por nuk përmendet fare zemljakja e Radoiçiqit, Limoza Kulari - Gadafi apo antikombëtare Hekuran Murati që mendimin për UÇK-në dhe luftën çlirimtare e ka si të Vulinit. Votat me postë të LDK-së e shembën diktaturën, e ndezën një dritë në fund të tunelit. Antikombëtarët dhe antiçlirimtarët e LV-së me votat e diasporës llogarisnin të fitojnë 50 deputetë. Pastaj, pasi e siguruan një mandat në pikën e LV-së në Livaxhë me aktivistin Nenad Rashiç, i bënë 51 deputetë e që mjaftonin ta bëjnë qeverinë Kurthi 3 pasi t'i bashkëngjisin edhe 10 vota të deputetëve të pakicave joserbe. Listën Serbe e ruanin si mundësi të artë. Nuk iu doli ashtu, me një këmbë janë në opozitë. Krejt varet nga opozita e tashme, aspak nga pushteti në largim.

Zgjedhjet përfunduan, si bëhet qeveria: Kemi rezultatet preliminare të zgjedhjeve, thuaja një muaj pasi përfunduan zgjedhjet. Kemi Listën e deputetëve që fituan mandatin përfaqësues. LV-ja kishte 47 mandate, me votat e Martin GEN Strugës dhe Donikë Zezës - Shvarc, me rrugaçëri në QNR e fituan vetëm një mandat, tash i kanë 48. PDK-së ua vodhën një mandat Martin GEN Struja dhe Donikë Zeza, bashkë me rrugaçet e QNR-së që me muskuj prej huliganëve donin ta shndërronin në arenë të Arteve marciale. LDK-ja ruajti 20 deputetë sikur që AAK-Nisma mbetën në 8 deputetë. Si e formon LV-ja qeverinë? Shumë lehtë. I ka 48 mandate, 49 me Rashiçin dhe 59 me deputetët joserbë. Nëse riaktivizohet hot line apo linja e nxehtë Kusari - Radoiçiq, nuk shoh arsye të ndodhë ndryshe, LV-ja e bënë qeverinë me 69

deputetë. Ndërkombëtarët do të përjetonin orgazëm me këtë kombinim. Nëse Serbia, për ta ngritur pazarin politik e mbanë anash Listën Serbe atëherë opozita e tashme, edhe pa Listën Serbe do ta formonte qeverinë me 62 deputetë. Krejt varet nëse opozita do të bashkohej, pa kushtëzime. Politikisht dhe strategjikisht, nëse LV-ja e formon qeverinë e pakicës pashmangshëm do të shembej. Opozita do të forcohej për zgjedhje të radhës. Mirëpo, në rastin që e kemi, lënia e qeverisë në duar të autokratit Kurti paraqet rrezik të madh. Ose duhet të formohet një qeveri me konsensus të gjerë, pa Kurtin kryeministër ose do të përfundojmë si Koreja e Veriut. Me Marrëveshjen e Brukselit dhe Ohrit, Albin Kurti e ka dhunuar brutalisht integritetin territorial të Kosovës sikur dhe sovranitetin. Kurti është i gatshëm ta nënshkruan këtë marrëveshje, madje këmbëngul. E pamë si mashtuan bashkë me Donikë Zezën për Manastirin e Deçanit, më shumë se tre vite refuzuan ta zbatojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, brenda natës e bënë mashttrimin duke ua lëshuar fletën poseduese popave të Manastirit për pronat që ua kishte ndarë Millosheviqi. Kurti para zgjedhjeve e ka luajtur të fortin, pas zgjedhjeve, nëse udhëheq në qeverinë do të realizojë çdo detyrim që e ka pranuar. Nëse e merrni Listën e 10 më të votuarve të LV-së, 80 për qind janë antikombëtarë dhe antiuq, mos të flasim nëse lëshohemi në pjesën tjetër të listës. Veteranët e luftës bënë mirë që nuk u zhytën në kanalizimin antikombëtar dhe anti-UÇK të Hajnullah Çeko, Faraonit të Pejës, Hekuran Paramilitarit, Donika Zezës, Zhivadinit të punëve të brendshme, doktor hajnit dhe

pencave tjerë. Nëse opozita e formon qeverinë nuk duhet ta zbatojë marrëveshjen e Brukselit dhe të Ohrit. Nëse e zbaton, le të bashkohet me Kurthin, më m..t nuk bëhet. E mira e së mirës është të mos bashkohen me Kurthin, në asnjë kombinim. Mos të certifikohen si hajvanë të Kurthit. Kurthi është në zor të madh, ka nevojë për të gjithë që e pranojnë çizmen e tij. Sikur që e kanë pranuar këta pecët e LV-së. Rrezik paraqesin këta që janë mbetur jashtë loje. Këta të LV-së e duan ta formojnë qeverinë me çdokënd sepse iu lirohen vendet për rehatimin e prapanicave të tyre. Edhe këta të opozitës e kanë të njëjtin hall. Mirëpo jam i sigurt se qeveria e ardhshme nuk lind pa ndrikullat ndërkombëtare. Shumë shpejt e shohim.

Kurthi vs Drejtësisë: Albin Kurti nuk njeh Prokurori apo Gjykatë jashtë LV-së. I fyen prokurorët dhe gjykatësit vet si luan. Për të mbajtur kondicionin kundër drejtësisë i ka zagaret kujdestarë! Nuk po paraqitet në Prokurori sepse po i fton në zyrën e tij që e ka shndërruar në Prokurori kundër armiqve politikë, mediave armike, shoqërisë civile armike. Kurti nuk ka kundërshtarë, ka vetëm armiq të projektuar. Me mishin e tyre i ushqen gladiatorët partiakë. Albin Kurthi nuk dorëzohet, vetëm shkruan. Atë që e shkruan e plason si të vërtetë të vetme, të pakundërshtueshme. Që e bënë në emër të humanizmit, për njerëzimin dhe për qytetërimin. Daç Shullc, një kryebandit dhe kryekriminel i viteve të 30-ta në Amerikë, ndonëse kushte vrarë shumë të pafajshëm, kishte plaçkitur dhe dhunuar kudo ku ka mbërritur, në çastin kur ishte plagosur për vdekje nga agjentët federalë, me gjakun e tij kushte

shkruar në mur porosinë e fundit: “po vdesë për të mirën e njerëzimit dhe mbrojtje të ligjit...”. Albini po e sfidon shtetin përmes mohimit të ligjit. Sigurisht se nuk ia del. Pablo Eskobari, në majat e lavdisë së tij kur kushte një armatë sa tre herë FSK e sotit, 15.000 ushtarë, me armatim të rëndë, helikopterë dhe madje edhe aeroplanë, nuk e mundi shtetin e Kolumbisë. Ai caktonte kush do të bëhet kryetar dhe deputetë, prokurorë dhe Gjykatës, sikur Kurti sot. Madje, e ndërtoi një burg vetëm për veten e tij. Përkundër të gjithave, i erdhi puna pisk nga ushtria kolumbiane dhe DEA amerikane. Kur me një rast bënte ftohtë, për ta ngrohur vajzën e vogël dhe veten, në vend të druve që nuk i kishte, ua vuri flakën disa miliona dollarë, që i kishte me shumicë. As kjo nuk e shpëtoi, e vranë sikur të ishte një hajn i pulave. E humbi pushtetin, e humbi edhe jetën. Kur po e krahasoj situatën aktuale të Albin Kurtit që nuk e ka pushtetin real, po më kujtohen Miti i Fetomit dhe poema e Gëtes: “Nxënësi i Magjistarit”. Nga këto dy raste del një porosi e qartë: “Kurrë mos ushtro pushtet, të cilin nuk mund ta kontrollosh!” LV-ja, përveç injorantëve që e përbëjnë shumicën absolute, ka edhe intelektualë të kalibrit të prof. dr. Ramçes i cili shumë lexon mediat e huaja, ato të Beogradit dhe Sputnikun. Prandaj edhe dominon mbi analistët e vdekshëm. Ai mund t'ua zbërthejë elitës injorante të LV-së edhe Mitin e Fetomit si dhe poemën e Gëtes. Deri vonë nuk e kam kuptuar pse Albini ka rreth vetes aq shumë injorantë. E kuptova kur e lexova një shprehje të njohur të George Orwell-it: “Injoranca është forcë”. Prandaj është Albini aq i fuqishëm.

Kryetari i Rahovecit takon punëtorët e administratës komunale, kërkon përkushtim në punë

Rahovec, 6 mars- Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka takuar punëtorët e administratës komunale, të cilëve u ka shprehur mirënjohje për

punën që bëjnë dhe nga ta ka kërkuar të jenë edhe më të përkushtuar. “Meqë shërbimin ndaj qytetarëve e ndiejmë si një detyrim themelor, sot, takova dhe

diskutova me punëtorët e administratës komunale, u shpreha mirënjohje për punën që bëjnë dhe prej tyre kërkoja të jenë edhe më të përkushtuar. Vetëm

me përpjekje të përbashkëta mund të ofrojmë shërbime cilësore dhe të jemi më afër qytetarëve”, ka thënë Latifi pas takimit.



LIDERËT SHTETËRORE BËJNË HOMAZHE NË PREKAZ:

Kullat e Jasharëve u shndërruan në simbol të një kalaje të lirisë

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeparlamentari Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur lule në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, në nderim të 27-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ata kanë theksuar se familja Jashari është krijuesja dhe esenca e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila e ka bërë aktin më sublim të sakrificës për lirinë e Kosovës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 MARS - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryeparlamentari Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti kanë bërë të enjten homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, me rastin e 27-vjetorit të Epopesë së UÇK-së. Presidentja Osmani ka thënë se sot, sikurse çdo vit, përkujtojmë Epopenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila i dedikohet përkujtimin tonë të përbashkët në këtë kohë lirie për secilin dëshmor, për secilin hero, për secilin martir që ka dhënë jetën për Kosovë por, mbi të gjitha, i kushtohet sakrificës, guximit dhe trimërisë së pashoq, të treguar nga familja Jashari më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari. “Ata luftuan shumë më gjatë sesa vetëm përgjatë viteve të luftës, duke u shndërruar kështu në emblema të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, njëkohësisht duke i shndërruar Kullat e Jasharëve në simbol të një kalaje të lirisë, e cila edhe sot e mbron Kosovën, e mbron lirinë, pavarësinë dhe sovranitetin e saj”, ka thënë Osmani. Sipas presidentes Osmani, këtu

jo vetëm ne si breza që e përjetuam luftën, por edhe brezat e rinj, edhe fëmijët tanë inspirohen për rrugën përpara. “Nga këtu jo vetëm ne si breza që e përjetuam luftën, por edhe brezat e rinj, edhe fëmijët tanë inspirohen për rrugën përpara, për mbrojtjen e lirisë së arritur me sakrificë e me gjak por, mbi të gjitha, na përkujtohet secilit se sa i lartë ka qenë çmimi i paguar për lirinë tonë, sepse përveç komandantit legjendar, i cili luftoi së bashku me babanë e tij, Shabanin, vëllanë, Hamzën dhe me shumë anëtarë të familjes, siç e dini, shumica e rënëve nga familja Jashari ishin gra dhe fëmijë që e bënë edhe shumë më të madhe dhe më të shenjtë këtë sakrificë të familjes Jashari”, ka theksuar presidentja. Presidentja ka thënë se asnjëherë nuk duhet të harrojmë, asnjëherë nuk duhet të devijojmë nga rruga e shtruar, nga kjo sakrificë e heronjve, dëshmorëve e martirëve. “Asnjëherë nuk duhet të harrojmë, asnjëherë nuk duhet të devijojmë nga rruga e shtruar, nga kjo sakrificë e heronjve, dëshmorëve e martirëve dhe gjithnjë kjo rrugë dhe kjo sakrificë do të shërbejë për secilin prej nesh si dritë udhërrëfyese në forcimin e



Kosovës, e cila çdo ditë po bëhet më e fortë dhe më prosperuese për qytetarët e saj. Lavdi të gjithë heronjve të kombit! Rroftë Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe Republika e Kosovës për të cilën ata e dhanë jetën!”, ka thënë presidentja Osmani, e cila pastaj është prituri në kullën e Jasharëve nga baca Rifat. Kreu i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka theksuar e familja Jashari është krijuesja dhe esenca e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila e ka bërë aktin më sublim të sakrificës për lirinë e Kosovës. “Anëtarët e familjes Jashari e kanë pasur të

mishëruar në zemrat dhe shpirtin e tyre një të vërtetë, që e ka shpëtuar popullin e Kosovës. E kjo e vërtetë është se liria nuk fitohet pa i kapur armët në dorë dhe nuk fitohet pa i dhënë dëshmorët e vet”, ka deklaruar Konjufca. Kreu i Kuvendit shtoi se për shkak të kësaj sakrifice ne si komb, për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, i detyrohemi më së shumti familjes Jashari. Pas homazheve, kryetari Konjufca së bashku me kryeministrin Kurti dhe anëtarë të tjerë të delegacionit, u mirëpritën në kullë nga vëllai i komandantit legjendar Adem Jashari, Rifat Jashari.

Ndërkaq kryeministri Kurti ka thënë se tre breza të Jasharëve, 59 veta gjithsej, rreth gjysma gra e fëmijë, u flijuan me 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998, për çlirimin e Kosovës, për lirinë, pavarësinë dhe bashkimin. “Epopeja e UÇK-së i dha një hov të pandalshëm kryengritjes së armatosur dhe luftës çlirimtare. Shpërthyen demonstrata gjithëpopullore dhe solidaritet i paparë historikisht ndërmjet shqiptarëve në Ballkan, por edhe gjithandej në mërgatë, njëkohësisht edhe u vetëdijesuan dhe ndërgjegjësua publiku ndërkombëtar dhe diplomacia botërore”, ka deklaruar Kurti.

Qeveria shqiptare miraton mbylljen e TikTok-ut

TIRANË, 6 MARS - Qeveria shqiptare miratoi më 6 mars mbylljen e platformës sociale TikTok në gjithë territorin e Shqipërisë për një vit. Propozimi për mbylljen e TikTok-ut ishte bërë në fund të vitit të kaluar nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama. Sipas qeverisë, vendimi është marrë pas konsultimit me prindër dhe mësues dhe rekomandimi për mbylljen e përkohshme të kësaj platforme është bërë nga një grup ndërinstytucional. “Është mbyllje e përkohshme e qasjes në TikTok. I kemi dhënë vetes deri në 12 muaj kohë që t'i marrim të gjitha masat e nevojshme në bashkërendim me përfaqësuesit e kësaj platforme që t'i marrim masat për të vendosur kushte dhe kriteret që qasja në TikTok të mos dëmtojë fëmijët dhe të rinjtë. Agjencia Kombëtare e

Sigurisë Kibernetike brenda disa ditëve apo javësh do të mund të realizojë këtë ndërprerje të përkohshme të qasjes në TikTok”, tha ministrja e Arsimit, Ogerta Manastirliu. Ajo tha se janë marrë informacionet e duhura nga Policia e Shtetit se ka pasur një numër të lartë të videove dhe materialeve të tjera të publikuara në këtë platformë që nxisin akte dhune dhe bullizmi. Sipas saj, rreth 65 000 prindër janë pyetur për këtë vendim në mbi 1 300 takime dhe janë shprehur në favor të mbylljes ose kufizimit të TikTok-ut. Konsultimet me prindër dhe mësues nisën pasi Shqipëria u trondit më 18 nëntor të 2024 kur Martin Cani, nxënës i shkollës 9-vjeçare “Fan Noli”, u vra me thikë nga bashkëmoshatari i vet në



qendër të Tiranës. Pas vrasjes së tij qarkulluan video në TikTok, ku të miturit shpreheshin pro vrasjes. Gjithashtu, pas vrasjes së tij u publikua fotografia e autorit, i cili u arrestua, që tregonte plagën që kishte marrë në dorë dhe ai u shfaq duke ngritur grushtin lart. Pas vendimit të qeverisë reagoi kreu i Partisë Demokratike në opozitë, Sali Berisha. Sipas tij, qeveria po e censuron këtë platformë në

kulmin e fushatës elektorale pasi, siç tha ai, ka frikë nga fjala e lirë dhe ndikimi i saj te të rinjtë. Për ta kundërshtuar këtë vendim, Berisha thirri një protestë kombëtare në Tiranë më 15 mars. Edhe në Kosovë ka pasur shqetësime lidhur me TikTok-un, pasi ka pasur dhjetëra raste të vetëlëndimeve të fëmijëve nga të ashtuquajturat sfida në këtë platformë sociale. Megjithatë, deri më tani në Kosovë qasja në TikTok është ndaluar vetëm brenda institucioneve shtetërore. Vendimi i qershorit të vitit 2024 i Qeverisë së Kosovës ishte arsyetuar me rreziqet kibernetike që paraqet kjo platformë. Edhe shtete të tjera kanë ndaluar instalimin e aplikacionit në telefonat e

punës. TikTok është platformë e videove të shkurtra që është në pronësi të kompanisë kineze, ByteDance. Në fillim të janarit të këtij viti, aplikacioni u ndalua përkohësisht në Shtetet e Bashkuara, pasi një ligj atje i ka kërkuar kompanisë që t'i shkëpusë raportet me partnerët që gjenden në Kinë dhe ligjvënësit kanë shprehur shqetësime se aplikacioni paraqet kërcënime për sigurinë kombëtare. Firmat e sigurisë kibernetike kanë sugjeruar se TikTok-u është i aftë t'i mbledhë të dhënat e përdoruesve përtej asaj çfarë përmbajtje ata shohin në këtë platformë, dhe Kina miratoi një ligj më 2017 që i detyron shtetasit kinezë që jetojnë jashtë vendit, të bashkëpunojnë me aparatin e saj të inteligjencës.

Uji i Kosovës në Maqedoninë e Veriut përplas qëndrimet e autoriteteve për cilësinë

PRISHTINË, 6 MARS - Institucionet e Kosovës dhe ato të Maqedonisë së Veriut kanë qëndrime të kundërta për cilësinë e ujit nga kompania “Rugove”.

Agjencia e Ushqimit dhe e Veterinarisë (AUV) e Kosovës i kundërshton pretendimet e homologëve maqedonas se në ujin burimor të kompanisë “Rugove” ka prani të bakterit koliform.


Reagimi i kësaj agjencie vjen dy ditë pasi Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Maqedonisë së Veriut njoftoi se po i inspektonte të gjitha dërgesat e ujit burimor nga Kosova pasi, siç tha, disa analiza të mëhershme zbuluan praninë e bakterit koliform në një mostër uji.

Disa medie në këtë vend publikuan edhe vendimin e agjencisë, sipas të cilit, bëhet fjalë për mostra të ujit “Rugove”.

AUV i Kosovës thekson se pas raportimeve në medie mbi dyshimet për sigurinë e produktit ujë “Rugove”, ka nisur gjurmimin e të gjitha të dhënave për këtë operator ekonomik. Analizat, sipas kësaj agjencie, tregojnë se uji “Rugove” është i sigurt për pije. Por, homologët në Maqedoninë e Veriut paralajmërojnë analizë të re, sipas tyre, neutrale.

AUV i Kosovës: Nuk ka bakter koliform në ujin ‘Rugove’

Të dhënat, sipas AUV-it, tregojnë se në muajin e fundit janë eksportuar gjithsejtë 27 ngarkesa, të cilat janë certifikuar në bazë të rezultatit të analizave laboratorike, të cilat janë kryer në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës. “Në këto rezultate të analizave është i përfshirë edhe parametri lidhur me ‘prezencën e bakterit koliform’. Në secilin rezultat është



konfirmuar se nuk është gjetur ky bakter në produktin ujë i ambalazhuar i kompanisë ‘Rugove’, thuhet në një komunikatë të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës.

Kjo agjenci thekson se nuk ka pranuar asnjë informatë zyrtare nga autoritetet homologe të Maqedonisë se Veriut lidhur me dyshime rreth sigurisë së ndonjë ngarkese me ujë të pijshëm. Gjithashtu, nga të dhënat e kontrollit kufitar nuk është gjetur se ka pasur ndonjë ngarkesë me ujë të refuzuar, apo kthyer nga ndonjë shtet tjetër në këtë periudhë kohore. Sipas AUV-it, uji i ambalazhuar “Rugove” i plotëson kriteret ligjore dhe është i sigurt për pije.

Vërejtjet e autoriteteve kompetente maqedonase lidhur me ujin “Rugove”, një ditë më herët, i ka cilësuar të paqëndrueshme edhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, ku bëhen analizat e rregullta të këtij uji. Drejtor i Laboratorëve për Analizat e Ujit dhe Ushqimeve në këtë institucion, Ergyl Binqe, i tha Radios Evropa e Lirë se

“nuk janë gjetur asnjëherë baktere të dëmshme për shëndetin e konsumuesve” në ujin “Rugove”.

Ekspertët për ujëra në IKShPK, lidhur me konstatimin e kolegëve maqedonas, kanë theksuar se mund të jetë “gabim njerëzor në laborator ose në diagnostikim”. Më herët nga kompania “Rugove” kanë konfirmuar për Radion Evropa e Lirë se produkti i saj është në rregull dhe se shitjet në shtetin fqinj janë duke vazhduar.

Institucionet e Maqedonisë së Veriut paralajmërojnë “super analizë”

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Maqedonisë së Veriut ka paralajmëruar se uji nga Kosova do të testohet sërish përmes një “super analize”. Boshko Stojkoski nga Sektori i Mbikëqyrjes së Inspektimit në këtë agjenci tha për Radion Evropa e Lirë se ngarkesa e ujit të importuar nga kompania

“Rugove”, në të cilën agjencia pohon se më 12 shkurt zbuloi se kishte një sasi të shtuar të baktereve koliforme, nuk ishte lëshuar në qarkullim. “Çelësi tani është që të bëhet super analiza dhe pas marrjes së rezultateve do të vendoset nëse uji është i sigurt apo jo. Ajo do të bëhet në një laborator të tretë me metoda të akredituara”, tha Stojkoski.

Ai sqaroi se bëhet fjalë për një ngarkesë prej afërsisht 22 mijë litra ujë nga e cila Agjencia e

Kontrollit Kufitar të Maqedonisë së Veriut mori një mostër dhe konstatoi se kishte një sasi të shtuar të baktereve koliforme. Stojkoski shton se përderisa priten rezultatet e “super analizës”, mbetet në fuqi masa protokollare, sipas së cilës, nga 10 dërgesat e ardhshme merren mostra për testim të detyrueshëm laboratorik. “Ajo masë mbetet në fuqi sepse më vonë është gjetur në dërgesat e tjera, ku është konstatuar, si në mostrën e parë, se ka dalë pozitive për disa baktere, por nuk do të hyj në detaje se cilat”, thotë Stojkovski, duke mos saktësuar se për çfarë bakteresh bëhet fjalë.

Këto dërgesa të ujit nga Kosova, për të cilat Stojkoski tha se përmbajnë sasi të shtuar të baktereve të paautorizuara, nuk janë lëshuar në qarkullim.

Sipas të dhënave të Byrosë së Prokurimit Publik të Maqedonisë së Veriut, janë 23 institucione të këtij vendi, të cilat, përmes një kompanie të atjeshme, furnizohen me ujin “Rugove”.

Disa prej këtyre institucioneve - si Ministria e Administratës Publike - konfirmuan për Radion Evropa e Lirë në Shkup se e kanë konsumuar dhe vazhdojnë ta konsumojnë ujin “Rugove”.

Çfarë është bakteri koliform?

Bakteri koliform është organizëm i pranishëm në mjedis dhe në jashtëqitjet e të gjitha kafshëve me gjak të ngrohtë dhe njerëzve. Bakteri koliform nuk mund të shkaktojë sëmundje. Megjithatë, prania e tij në ujë të pijshëm tregon se organizmat që shkaktojnë sëmundje (patogjenët) mund të jenë në sistemin e ujit,

thuhet në përshkrimin që bën Departamenti i Shëndetësisë i Shtetit të Uashingtonit. Sipas tij, nëse bakteri koliform gjendet në një mostër uji, operatorët e sistemit të ujit punojnë për ta gjetur burimin e ndotjes. Një nga mënyrat për pastrimin e ujit të kontaminuar është përmes klorifikimit.

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, e shqetësuar me kamatat e larta të kredive nga bankat komerciale

PRISHTINË, 6 MARS - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (DhTIK) ka shprehur sërish shqetësimin për kamatat e larta të kredive nga bankat komerciale në vendin tonë. Megjithëse, sipas DhTIK-ut, edhe në raportet e BQK-së kreditë e këqija vazhdojnë të jenë shumë të ulëta, ndërsa bankat mbeten dorështrënguese sa i përket dhënies së kredive me norma më të favorshme të interesit. “Kjo qasje po u shkakton probleme të mëdha bizneseve tona, të cilat, përkundër shumë sfidave, po përpiqen t’i zgjerojnë investimet e tyre. Numër i madh i bizneseve tona anëtare kanë raportuar për norma të larta të interesit dhe

administrata joefikase”, është thënë në reagimin e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë (DhTIK).

Sipas DhTIK-ut, mungesa e likuiditetit është jetike për ta mbështetur prodhimin dhe eksportet. “Derisa në vendet e rajonit shtetet kanë ndërmarrë veprime të ndryshme, ku sipas të dhënave që i kemi mbledhur, normat e interesit në kredi janë shumë më të ulëta. Madje ka shtete të cilat kanë marrë iniciativa për t’i inkurajuar bizneset edhe nga Kosova që të bartin prodhimin, duke iu ofruar kushte shumë më të favorshme, përfshirë edhe kamata shumë më të ulëta sesa ato që i ofron sektori bankar në Kosovë”, në reagimin e DhTIK-



ut. Me këtë rast, Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë e Kosovës (DhTIK) u ka bërë thirrje institucioneve kompetente shtetërore, BQK-së dhe sektorit bankar, që të ndërmarrin hapa

të menjëhershëm në mbështetje të bizneseve, pasi nga kjo qasje po pëson ekonomia edhe ashtu e brishtë e vendit, e cila përballet me numër të madh të sfidave. Bankat komerciale në Kosovë

vazhdojnë t’i rritin fitimet e tyre vit pas viti. Ky sektor financiar në vend ka arritur të ketë profit të lartë gjatë vitit 2024. Sipas raportit të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) për vitin 2024, nga kreditë bankare dhe shërbimet e tjera ndaj qytetarëve dhe bizneseve, bankat komerciale kanë pasur fitim të pastër 182.1 milionë euro ose rreth 27 milionë euro më shumë se në vitin 2023. Në vitin 2023 profitti i bankave ishte 155 milionë euro.

Norma e interesit mesatar është mbi 6 për qind. Sipas BQK-së, vlera e kredive për ekonomitë familjare, biznese dhe korporata të tjera financiare, arrin 5 miliardë e 813.4 milionë euro.

EVROPA E PËRÇARË KËRKON PËRGJIGJE TË BESUESHME PËR UKRAINËN

Një moment historik për Evropën



Gjatë fundjavës që kaloi, Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Sir Keir Starmer, priti atë që e quajti një “koalicion të vullnetarëve”. “Në njëfarë mënyre, Trump po na bën një nder, nëse zgjedhim ta shohim kështu. Përndryshe, këto kohë janë tepër të errëta.” Këto janë fjalët e një diplomati nga një prej vendeve kryesore evropiane, pas ndërprerjes së ndihmës ushtarake amerikane për Ukrainën nga Donald Trump. Ai kërkoi të mbetej anonim për të shprehur mendimet e tij më lirshëm. Shpejtësia e ndryshimeve në Uashington është marramendëse, jo vetëm për publikun, por edhe për politikanët. Evropa po përpiqet të reagojë në mënyrë efektive, me një valë të paprecedentë aktivitetesh diplomatike: Telefonata urgjente mes liderëve evropianë gjatë natës; Takime dypalëshe në Londër dhe Paris; Mbledhja e ministrave të mbrojtjes të NATO-s në Bruksel; Një samit urgjent i BE-së për sigurinë të enjten.

“Ky është një nga momentet më vendimtare në historinë evropiane.”

Shumica e vendeve evropiane

besojnë se në rrezik nuk është vetëm sovraniteti i Ukrainës, por edhe siguria e gjithë kontinentit, ndërsa Rusia kërkon të çmontojë ekuilibrin e pushtetit perëndimor të vendosur pas Luftës së Ftohtë. Por çfarë po arrijnë realisht këto takime të nivelit të lartë? Vetëm disa orë para se Uashingtoni të ndalonte ndihmën ushtarake për Kiev, Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Sir Keir Starmer, i cili po merr një rol udhëheqës në Evropë për Ukrainën, deklaroi se kishte ardhur koha për “veprime, jo fjalë”. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ndërkohë, tha se Evropa duhet ta ndihmojë Ukrainën me dërgesa të menjëhershme dhe shtesë të armëve. Por a mund të veprojë kontinenti si një i vetëm? Evropa është një bashkësi vendesh me buxhete të ndryshme dhe politika të brendshme e prioritete të larmishme.

Dy objektivat e Evropës

1. Të bindë Donald Trump-in që Evropa po merr përgjegjësinë e saj në mbrojtjen e sigurisë. Liderët evropianë shpresojnë që kjo ta bindë atë të rinisë mbështetjen ushtarake për Ukrainën dhe të ruajë garancitë e sigurisë për

Evropën.

2. Të forcojë urgjentisht mbrojtjen dhe mbështetjen për Ukrainën, në rast se Trump tërhiqet plotësisht nga konflikti – apo edhe më keq, nga mbrojtja e Evropës në tërësi.

Por Evropa nuk është duke e bërë këtë vetëm për Uashingtonin. Moska gjithashtu po vëzhgon. Nëse samitet evropiane nuk prodhojnë rezultate konkrete dhe të shpejta, atëherë në sytë e Kremlinit, Evropa do të duket e dobët dhe e përçarë. Rusia tashmë ka shprehur gëzim për “çarjet” që shoh në unitetin perëndimor.

Evropa ende e varur nga SHBA

Donald Trump thotë se i beson Vladimir Putinit, por ka qenë përçmues ndaj aleatëve të NATO-s dhe e ka quajtur presidentin e Ukrainës një diktator. Pavarësisht retorikës evropiane për një mbrojtje të pavarur, çdo ekspert sigurie e pranon se Evropa ende ka nevojë për SHBA-në, të paktën në afatin e shkurtër dhe të mesëm. Për këtë arsye, javën e kaluar në Uashington, presidenti francez dhe kryeministri britanik u përpoqën ta afronin Donald Trump-in. SHBA ka mbuluar boshllëqet e mëdha

të mbrojtjes evropiane, të shkaktuara nga dekada të tëra të investimeve të pamjaftueshme pas Luftës së Ftohtë.

Nëse Mbretëria e Bashkuar dhe Franca arrijnë të krijojnë një “koalicion të vullnetarëve” – vende evropiane që pranojnë të dërgojnë trupa paqeruajtëse në Ukrainë pas një armëpushimi – kjo mund të zbulojë dobësitë e mbrojtjes së NATO-s. Kjo është arsyeja pse Polonia nuk dëshiron të dërgojë trupa. Ajo thotë se i duhet t’i mbajë ushtarët në vend për t’u mbrojtur nga Rusia dhe shpreson fuqimisht që SHBA të mos tërheqë trupat e saj nga Evropa Lindore.

“A mund ta mbulojë Evropa boshllëkun që la SHBA?”

Por Evropa varet gjithashtu nga SHBA për aftësi ushtarake kritike, të njohura si “enablers” (mundësuesit). Ukraina mbështetet shumë në inteligjencën amerikane për të mbajtur avantazhin ndaj Rusisë. Por të mërkurën, Financial Times raportoi se SHBA kishte ndaluar ndarjen e inteligjencës me Kievin, duke e dobësuar ndjeshëm aftësinë e Ukrainës për të goditur forcat ruse. Çdo forcë paqeruajtëse evropiane në Ukrainë do të kishte nevojë për ndihmën e

SHBA-së për të vendosur një mburojë ajrore mbi Ukrainën. Evropa nuk ka kapacitete të mjaftueshme për furnizim ajror apo municione për të neutralizuar mbrojtjen ajrore ruse. Këto aftësi “nuk blihen në një supermarket të lagjes”, siç thotë një politikan evropian.

A është Evropa gati të shpenzojë më shumë?

Për Ukrainën, Evropa mund të mbulojë ndihmën aktuale të SHBA-së, nëse e ndan mendjen për ta bërë këtë. Gjermania është donatori më i madh ushtarak i Ukrainës pas SHBA-së. Berlioni dhe vendet e Evropës Veriore shprehin pakënaqësi ndaj Francës, duke argumentuar se ajo flet shumë për mbrojtjen e Ukrainës, por kontribuon pak. Ursula von der Leyen deklaroi se “Evropa po hyn në një epokë riarmatimi”, duke sugjeruar mobilizimin e 800 miliardë eurove për mbrojtjen. Nëse Trump tërhiqet plotësisht nga Evropa, ekspertët thonë se kontinenti duhet të shpenzojë midis 4-6% të PBB-së për mbrojtje – një “tërmet” politik, social dhe ekonomik, të cilin liderët evropianë shpresojnë të mos e ndeshin kurrë. / BBC – bota.al



Asani në formacionin e javës në K-League

Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Jasir Asani, ka zënë vend në ekipin më të mirë të xhiros tretë në Kampionatin e Koresë

së Jugut. Asani shkëlqeu në ndeshjen e fundit, duke i siguruar fitoren ekipit të tij, Gwangju, me përmbysje të rezultatit.

Gwangju triumfoi 2:1 ndaj FC Anyang, ndërsa Asani shënoi të dyja golat për vendasit që pas tri xhirove kanë tubuar 5

pikë në K-League. Asani është vlerësuar për paraqitjen e tij me notën 8.3 për t'u përfshirë në formacionin e javës. Në

11 ndeshje të luajtura në të gjitha garat deri më tani, 29-vjeçari ka shënuar 10 gola dhe ka bërë 1 asistim.

Dy derbi në Superligë

“Epoka e re”

PRISHTINË, 6 MARS - Dy ndeshje derbi do të zhvillohen në xhiron e 23-të të Superligës së Kosovës në futboll. Kjo xhiro fillon sot (e premte) me ndeshjen në mes të Ferizajt dhe Suharekës, e cila fillon nga ora 14:00. Ferizaj pësoi humbje në ndeshjen e fundit dhe tash synon t'u kthehet rezultateve pozitive, derisa synim të njëjtë ka edhe Suhareka që ka pësuar humbje në tri ndeshjet fundit në elitë. Të shtunën zhvillohen dy ndeshjet derbi ku vëmendja do të jetë në ndeshjen në mes të Ballkanit dhe Prishtinës. Në xhiron e fundit, Ballkani u befasua nga Malisheva dhe tash pret fitore ndaj kryeqytetasve në mënyrë që mos të lejojë të shtohet diferenca e pikëve me skuadrën lidere, Dritën. Prishtina synon të marrë rezultat pozitiv nga kjo ndeshje dhe ta vazhdojë ngritjen në tabelë. Duhet cekur se prishtinasit nuk dinë për fitore qe shtatë ndeshje dhe kjo ka bërë që të përfundojnë në vendin e pestë



SUPERLIGA

Të premten takohen:
Ferizaj - Suhareka

Të shtunën takohen:
Ballkani - Prishtina
Llapi - Drita

Të dielën takohen:
Gjilani - Feronikeli '74
Dukagjini - Malisheva

në tabelë.

Ndeshje shumë interesante do të jetë edhe ajo që zhvillohet në stadiumin “Zahir Pajaziti”, mes Llapit dhe Dritës. Pas dy barazimeve në dy ndeshjet e fundit, skuadra e Tahir Batatinës kërkon tri pikët ndaj kryesuesve të elitës, derisa gjilanasit do të vijnë të motivuar për fitore në mënyrë që ta ruajnë epërsinë e pikëve me skuadrat përcjellëse. Të

dielën Gjilani e pret Feronikelin '74, derisa në ndeshjen tjetër forcat do t'i matin Dukagjini i Klinës dhe Malisheva. Malishevasit synojnë pikët e plota, pasi mund të inkuadrohen në garën për titullin me ndonjë dështim të Dritës. Pritshmëri të mëdha kanë edhe djelmoshat që drejtohen nga Ismet Munishi pasi me tri pikë do të largohen nga pjesa e poshtme e tabelës.

SHKURT

Besa Famgas mposht Vushtrrinë

Ka nisur xhiro e 21-të e Superligës së Kosovës në hendboll në konkurrencë të meshkujve. Në palestrën “Jeton Tërstena - Tota” janë takuar Besa Famgas e Vushtrria. Fitore bindëse, me rezultat 44:25, shënoi skuadra pejane, Besa. Jon Vokshi i shënoi 14 gola për Besa Famgasin. Efikas ishte edhe aloja tjetër, i riu Ilir Istrefaj, që ndeshjen e përfundoi me dhjetë gola. Te Vushtrria më efikas ishte Egzon Ademi me gjashtë gola. Katër i realizoi Muhamed Halili. Besa është e dyta me 32 pikë. Vushtrria renditet e pesta me 14 pikë. Ndeshjet e tjera të xhiros së 21-të zhvillohen në fundjavë.

Besnik Hasi ndahet me ekipin belg

Besnik Hasi nuk është më trajner i KV Mechelenit. Lajmi është dhënë nga klubi belg në rrjetet sociale. Shkak për këtë vendim janë bërë rezultatet e dobëta, me palët që kanë vendosur ta ndërpresin bashkëpunimin. Kujtojmë se Hasi u emërua në krye të kësaj skuadre në nëntor 2023, pas shkarkimit të Steven Defour. Tekniku shqiptar ka drejtuar Mechelen në 56 sfida, me ekipin që ka marrë mesatarisht 1.45 pikë për ndeshje.

Drejtuesit e FFK-së bëjnë homazhe në Prekaz

Delegacioni i Federatës së Futbollit të Kosovës, i udhëhequr nga presidenti Agim Ademi, ka bërë homazhe në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, në kuadër të shënimit të 27-vjetorit të Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kjo vizitë përkujtimore e delegacionit të FFK-së u bë në shenjë nderimi për rezistencën dhe sakrificën sublime të komandantit Adem Jashari, familjes Jashari dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për lirinë e Kosovës. Delegacioni i FFK-së vendosi buqetë me lule në varrezat e dëshmorëve, duke shprehur mirënjohjen e thellë për kontributin e tyre në historinë e vendit tonë. Presidenti Agim Ademi pas homazheve theksoi rëndësinë e mbajtjes gjallë të kujtimit për Epopenë e UÇK-së dhe vlerat që ajo simbolizon. E në kuadër të shënimit të Epopesë së UÇK-së, edhe sivjet FFK në bashkëpunim me komunën e Skenderajt kanë organizuar turneun tradicional në futsall.

Xhaka: Kemi edhe 90 minuta, do të japim gjithçka

LEVERKUSEN, 6 MARS - Bayer Leverkuseni pësoi humbje nga Bayern Muncheni (3-0) në ndeshjen e parë të 1/8-tës së Ligës së Kampionëve. Futbollisti shqiptar Granit Xhaka është shprehur i zhgënjyer, por ende beson se ka lojë për kualifikim. “Sigurisht që zhgënjimi është i madh në këtë moment. Pavarësisht

pengesës së hershme, ne ishim mirë në lojë, nuk lejuam shumë dhe patëm një shans të mirë përmes Jeremie”, ka thënë Xhaka, i cili ka parë gjërat pozitive, duke vënë në dukje qëndrueshmërinë e skuadrës, pavarësisht deficitit. “Ne nuk e lejuam Bayernin të na dominojë plotësisht dhe treguam karakter të mirë për të

qëndruar në lojë”, ka shtuar ai. Mirëpo Xhaka vuri në dukje se kartoni i kuq ndryshoi rrjedhën e ndeshjes, duke pranuar se përjashtimi kishte një ndikim të rëndësishëm. “Kartoni i kuq e ndryshoi pak lojën. Kemi edhe 90 minuta ose më shumë. Ne besojmë në veten tonë dhe do të japim gjithçka!”, ka deklaruar Xhaka.



Norris paralajmëron rivalët: McLarenit në formë që në garën e parë

SURREY, 6 MARS - Pas testeve të kryera javën e kaluar, te McLarenit kanë besim se mund ta fitojnë titullin kampion për konstruktorë edhe këtë sezon në Formula 1. Në Bahrein, makina MCL39 tregoi një ritëm shumë më të lartë se ai i konkurrentëve. Të gjithë e konfirmojnë epërsinë e

McLarenit të paktën për sa i përket ritmit të garës, çka e bën makinën britanike favorite për ta fituar garën e parë sezonale, atë që zhvillohet më 16 mars në Australi. Lando Norris do të dojë të hakmerret për vendin e dytë në botërorin e vitit të kaluar, kur mori mësim nga Max

Verstappeni pavarësisht se kishte një makinë më të mirë. “Tani po analizojmë gjithçka që morëm pas testeve për t’u siguruar që jemi gati për Melburn”, ka thënë Norris. “Testet kanë mbaruar dhe mendoj se ishin tri ditë produktive. Provuam shumë gjëra dhe mësuam shumë.

Disa gjëra shkuan mirë, disa gjëra ende kanë nevojë për përmirësim, por për këtë është testimi”, ka shtuar britaniku. Më tej, Lando Norris komentoi: “Makina funksionoi shumë mirë, gjë që është një vend i mirë për të filluar. Kemi shumë për të rishikuar përpara Melburnit, por mendoj se do



të arrijmë atje në formë të mirë”.

Fitore me aromë ‘play-off’-i për Besëlidhjen, Ylli mposhti Tiranën

PRIZREN, 6 MARS - Janë zhvilluar katër ndeshjet në Ligën Unike në kuadër të javës së katërt. Në sfidën kryesore, Besëlidhja fitoi ndaj Bashkimit në Prizren me rezultat 76:84 (22:23, 18:21, 19:23, 17:17). Dirk Williams u dallua te vendasit me 19 pikë e gjashtë kërcime, derisa te mysafirët u dallua Xander Bowers me dhjetë pikë e 13 kërcime. Besëlidhja ka katër fitore e një humbje, kurse Bashkimi një fitore e tri humbje. Kjo fitore i siguroi skuadrës së Besëlidhjes kualifikimin në “Play-off”. Në ndeshjen tjetër të Grupit A, Vëllaznimi fitoi bindshëm ndaj Teutës me shifrat 93:69 (10:25, 20:12, 30:10, 33:22). Jericole Hellems ishte më i miri te vendasit me 22 pikë, nëntë kërcime e gjashtë asistime, kurse te mysafirët më i dalluar ishte Bryan Powell me 24 pikë e dhjetë kërcime. Vëllaznimi ka katër fitore e një humbje, ndërsa Teuta katër humbje në po aq ndeshje. Në Grupin B, Golden Eagle Ylli shënoi fitore ndaj Tiranës 62:87 (11:30, 20:24, 14:25, 17:8). Klein Strazimiri ishte më



i miri te vendasit me 13 pikë, pesë kërcime e tetë asistime, kurse te mysafirët disa lojtarë shënuan pikë dyshifrore, ndërsa Derrick Wilson e mbylli ndeshjen me 18 pikë, katër kërcime e gjashtë asistime, kurse Lis Shoshi kontribuoi me 17 pikë e tetë kërcime. Takimi ishte direkt për “play-off”, pasi tani skuadra tiranase ka dy fitore e tri humbje, ndërsa ajo therandase tri fitore e dy humbje. Në takimin tjetër të këtij grupi,

fitore bindëse shënoi Vllaznia ndaj Sigal Prishtinës 88:57 (20:8, 22:13, 25:18, 21:18). Arlando Arnold ishte më i miri te shkodranët me 12 pikë, 11 kërcime e 11 asistime, ndërsa bardhekaltrit u paraqitën vetëm me vendorë, ku Dion Sheqiri e mbylli ndeshjen me 15 pikë e nëntë kërcime dhe Jon Ismajli me 16 pikë e gjashtë kërcime. Vllaznia ka dy fitore e tri humbje, ndërsa Sigal Prishtina tri fitore e dy humbje.

Bostoni dhe Oklahoma sigurojnë fazën ‘play-off’, Hardeni nderon clippersat

BOSTON, 6 MARS - Skuadra e Clevelandit korri fitoren e dymbëdhjetë radhazi, duke mundur me rezultat 112-107 Miamin. 40 pikët e realizuara nga lojtarët e stolit ishin vendimtare për Cavaliersin, që kryeson renditjen në Konferencën e Perëndimit. Bostoni fitoi me rezultat 128-118 ndaj Portlandit dhe bëhet skuadra e Denverit, që mposhti më rezultat 116-110 Sacramenton, sfidë ku të gjithë titullarët e Nuggetsit realizuan mbi 10 pikë. Në Konferencën e Perëndimit



vijon të dominojë ekipi i Oklahomas, që mundi me rezultat 120-103 Memphisin jashtë fushës, duke u kualifikuar në “play-off”. Sërish protagonist Alexander Shai, që realizoi 41 pikë. Nuk zhgënjeu ekipi i Milwaukeees, që mundi me rezultat 137-107 Dallasin,

REZULTATET	
Boston - Portland	128-118
Charlotte - Minnesota	110-125
Cleveland - Miami	112-107
Washington - Utah Jazz	125-122
Milwaukee - Dallas	137-107
Denver - Sacramento	116-110
Memphis - Oklahoma	103-120
Clippers - Detroit	123-115

ndeshje ku Lillardit realizoi 34 pikë e Antetokounmpo 32 pikë. Fitore të rëndësishme për renditje korri skuadra e clippersave, që falë 50 pikëve të James Hardenit, mundi me rezultat 123-115 Detroitin.

SHKURT

Inzaghi lavdëron Asllanin

Trajneri i Interit, Simone Inzaghi, e ka lavdëruar mesfushorin Kristjan Asllani për paraqitjen që e pati ndaj Feyenoordit në Ligën e Kampionëve. Interi e fitoi këtë ndeshje me rezultat 2-0 dhe ka bërë një hap të madh drejt kalimit në çerekfinale. Mesfushori i Shqipërisë, Asllani, ishte titullar tek Interi dhe luajti deri në minutën e 80 për t’u zëvendësuar nga turku Hakan Calhanoglu. “Nuk kam pasur asnjëherë dyshime mbi cilësitë e Asllanit. Si trajner më duhet t’i kombinoj forcat dhe Asllani ka bërë që të mos ndihet mungesa e Calhanoglu, që rikuperoi energjitë pasi luajti në fundjavë kundër Napolit”, ka thënë trajneri i Interit. Asllani 22-vjeçar ka kontratë me Interin deri në vitin 2028, kurse këtë sezon ka shënuar 1 gol dhe ka bërë 2 asistime në 25 paraqitje në të gjitha garat.

Neueri u lëndua duke festuar golin, mungon disa javë

Munchen, 6 mars - Portieri i Bayern Munchenit, Manuel Neuer, do të jetë jashtë fushës për shkak të një çarje të fibrave muskulore në pulpin e djathtë, të pësuar pas një festimi goli gjatë fitores 3-0 të klubit në Ligën e Kampionëve ndaj Bayer Leverkusenit. Siç raportohet nga Florian Plettenberg, Neueri do të humbasë të paktën tri deri në katër ndeshje, duke përfshirë ndeshjen e kthimit në Leverkusen. Jonas Urbig, i cili u soll nga FC Koln në janar 2025, do ta zëvendësojë Neuerin në portë. Portieri i ri debutoi në ndeshjen e Ligës së Kampionëve pas lëndimit të Neuerit dhe pritet të vazhdojë në portë si titullar e ardhshme. Drejtori sportiv i Bayernit, Christoph Freund dhe ekzekutivi sportiv Max Eberl kanë shprehur besim në potencialin e Urbig, me shumë njerëz që e shohin atë si pasardhësin e ardhshëm të Neuerit. Urbig tani do të ngarkohet ta plotësojë portierin me përvojë gjatë mungesës së tij. Përditësimet për dëmtimin e Neuerit do të sigurohen pasi të ketë më shumë informacione, me rikuperimin e tij që pritet të zgjasë disa javë.

Alisson: Paraqitja më e mirë në jetën time

Portieri i Liverpoolit, Alisson Becker, ka qenë hero i “Reds”-it në ndeshjen e parë të së tetës së finales së Ligës së Kampionëve kundër Paris Saint-Germainit (0-1). Portieri brazilian ishte më meritor i që lideri i Premierligës doli nga fusha i pamposhtur. “Kjo ndoshta ka qenë paraqitja më e mirë në jetën time. Trajneri po më tregonte se sa e vështirë do të ishte të luajmë kundër PSG-së, se sa janë të mirë me topin dhe që do të duhej të ishim të gatshëm të vuanim. E dinim se çka po vinte”, ka thënë Alisson. “Kemi punuar fort. I lëshuam disa mundësi. Krejt sakrifica e ekipit ma bën punën më të lehtë. Në fund, Elliott hyri dhe shënoi gol, është një histori e madhe për ne. Ishte një natë e bukur”, ka përfunduar ish-portieri i Romës.

Alonso nuk e humbet besimin: Kemi përmbysur mjaft rezultate

Trajneri i Bayer Leverkusenit, Xabi Alonso, ka mbetur shumë i zhgënjyer nga paraqitja e skuadrës së tij, që u mund me rezultat 0-3 nga Bayern Muncheni në sfidën e parë

mes tyre në Ligën e Kampionëve. Një humbje që ndërlikon pa masë objektivat e “Aspirinave” në turneun kontinental. “Kemi bërë shumë gabime në këtë ndeshje

të parë, gjë që nuk duhej të ndodhte. Ishte faji ynë”, ka thënë Xabi Alonso. “Ne nuk e kishim kontrollin e ndeshjes dhe padyshim që kjo ishte shumë e bezdisshme. Do të

duhet pak kohë për ta kapërcyer këtë lojë, por ende nuk ka përfunduar asgjë për sa i përket kualifikimit”, ka shtuar trajneri spanjoll. “Gjëra të çmendura kanë ndodhur më

parë në futboll dhe ne do të luftojmë për javën e ardhshme, në ndeshjen e kthimit, në fushën tonë. Kemi treguar se mund të përmbysim rezultate”, ka deklaruar Alonso.

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A**

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A. Me Vendimin e KE-së nr. 02/01/193 të datës 05/03/2025 shpallet:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendeve të punës

Titulli i vendit të Punës:	“Inkasant” në KRM “Pastrimi” SH.A
Nr. i kërkuar:	Tri (3) pozita; Prishtinë
Numri i Referencës:	DF-KJ-06/2025
Koeficienti/Paga mujore:	Niveli XIV
Kohëzgjatja e Kontratës së Punës	Me kohë të pa caktuar
Periudha Provuese:	3 muaj

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Bënë inkasimin e mjeteve në bazë të faturave me të cilat është ngarkuar për amvisëri dhe biznese;
- 1.2 Bënë regjistrimin me kohë të sipërfaqeve të reja dhe të pa regjistruara dhe përcjellë ndryshimet e sipërfaqeve dhe ndryshimet tjera relevante në sektorin e amvisërisë dhe bizneseve;
- 1.3 Pas identifikimit të ndryshimeve relevante njofton udhëheqësin e drejtpërdrejtë dhe Mbikëqyrësin Financiar.
- 1.4 Mjetet e mbledhura të inkasimit i dorëzon brenda ditës në njërin nga bankat apo në arkën e kompanisë;
- 1.5 Barazohet me zyrtarin e financave lidhur me faturat e pranuar dhe pagesat e bëra;
- 1.6 Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara nga udhëheqësi;
- 1.7 Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të njësisë Operative.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën;
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Shkollim i mesëm
- ✓ **Përvoja e punës e kërkuar:** 1 vit përvojë pune profesionale

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar;
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
CV - në	✓
Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Kopjen e letërmjofimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës	✓
Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 6 muaj	✓

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyrat e Burimeve Njerëzore në KRM "Pastrimi" SH.A.

Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike;
punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 07/03/2025 deri me datën 21/03/2025.

Koha e fundit e pranimit të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (10) pikë;
- ✓ Testi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë;
- ✓ Intervista (testi me gojë) vlerësohet deri në njëzetë (20) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronik dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë:

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit.

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nerimane Ferizi B.I, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik: 811848491.
- Krenar Gjoshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollë së mesëm të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.
- Vetrim Haxhija nga Brovina e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesat klasës 1-5 të SH.F.M.U “Jahë Salihu”, Molliq.
- Besart Nushi shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 6-9 të SH.F.M.U “Dëshmorët Lleshi”, Doblibare, komuna e Gjakovës.
- Petrit Polloshka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Q.A.M.O “Kadri Kusari”, Gjakovë.
- Deshire Brovina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Ismet Berisha nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u “Hamëz Cena” Damjan KK Gjakovë nga kl. 1-8.
- Egzon Berisha nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan KK Gjakovë nga kl. 1 -8.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



Gjakovë, 06.03.2025



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar

Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom

Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 06.03.2025

Referenca: AAPSK – 005/2025

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/ copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	VW Passat ngjyrë e hirit, viti i prodhimit 2005, dizel- me targa të huaja- Rishpallje	1 copë	2,250.00€		
2	VW Golf III ngjyrë e hirit, manual, dizel- me targa te huaja- Rishpallje	1 copë	1,170.00€		
3	Kamion Mercedes Atego ngjyrë e bardhë, viti i prodhimit 2009, dizel- me targa të huaja- Rishpallje	1 copë	11,700.00€		
4	Volvo V70 ngjyrë e hirit, viti i prodhimit 2004, dizel- me targa të huaja- Rishpallje	1 copë	2,250.00€		
5	VW Seat ngjyrë e hirit, manual, dizel- me targa të huaja- Rishpallje	1 copë	1,350.00€		
6	VW Sharan ngjyrë e hirit, viti i prodhimit 2005, dizel- me targa të huja- Rishpallje	1 copë	2,430.00€		
7	Kamion Mercedes 1320L, ngjyrë e bardhë, viti i prodhimit 2002, dizel- targa te huaja	1 copë	7,000.00€		
8	Furgon Mercedes 814 DKA ngjyrë e kaltër,viti i prodhimit 2001, dizel -targa të huaja	1 copë	4,000.00€		
9	Furgon Iveco Daily, ngjyrë e gjelbër, viti i prodhimit 2003, dizel-targa të huaja	1 copë	3,000.00€		
10	VW Passat B5, ngjyrë e gjelbër,viti i prodhimit 1998, benzin- targa të huaja	1 copë	2,000.00€		
11	Kombi VW LT35, ngjyrë e gjelbër, viti i prodhimit 2002, dizel- targa vendore	1 copë	2,700.00 €		
12	VW Golf II ngjyrë e bardhe, manual - për skrap	1 copë për skrap	207.00€		
13	VW Golf II ngjyrë e kaltër metalike, viti i prodhimit 1987, benzin - për skrap	1 copë për skrap	213.44€		
14	Furgon VW Transporter LKVT5, ngjyrë portokallit, viti i prodhimit 2009, dizel- targa të huaja	1 copë	5,000.00€		
15	VW Sharan ngjyrë e kalter, viti i prodhimit 1997, dizel- - për skrap	1 copë për skrap	398.59€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohen më së largu deri më **13.03.2025 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.**

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: **13.03.2025**, prej orës 10:00-11:00 në **Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë**, kurse mallin me numër rendor **3,7,8 dhe 9** mund ta shikojnë me datë: **12.03.2025**, prej orës 10:00-11:00 në **Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë**.

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 258



Gjej PUNË

• Lajme nga tregu i punes

• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

CV-së

Letrën Motivuese

Parapregaditje për intervistë





www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



100% Fresh & Natural



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality

★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality

★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality

★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality

★ Industria e Comercio da Bebidas Funado Ltda Brazil, Quality

★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales

★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality

★ Obi Zulal CJSC Tajikistan, Quality

★ Parlex Sales Sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality

★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

